



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2020:128891
Datë: 10.01.2025
Numri i dokumentit: 06776916

P.nr. 1881/20

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtarja e vetme gjykuese Edita Çanta, me Bashkëpunëtorin Profesional Lavdim Mehmeti, në çështjen penale ndaj të pandehurëve M.G. dhe E.G. për shkak të veprës penale në bashkëkryerje *Sulm* nga neni 184 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë/Departamenti i Përgjithshëm, me shenjën PP.II.nr.3319/20, të datës 05.10.2020, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, i hapur për publikun, me datë 19.12.2024, në të cilin shqyrtim ishte i pranishëm Prokurori i shtetit Kastriot Berisha, të pandehurit M.G. dhe E.G., e në bazë të nenit 365 të KPPK-së, me dt.19.12.2024, mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datën 10.01.2025, e përpiloi me shkrim këtë:

A K T G J Y K I M

Të pandehurit:

I.M. G., nga i ati S. dhe e ema M., e gjinise G., i lindur më //, ne P., me adrese banimi ne rr. "I.K." //, me numër personal //, me nr. //, i martuar, baba i dy femijeve, ka te kryer shkollen e mesme, punon ne lokalin e vet fast Food N., i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

II.E. G., nga i ati S. dhe e ema M., e gjinise G., i lindur më //, ne P., me adrese banimi ne rr. "I. K.", me numër personal //, me nr tel ///, i martuar, baba i dy femijeve, ka te kryer shkollën e mesme, punon ne lokalin e vet fast Food N. i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

JANË FAJTOR

Sepse:

Me datë 18.08.2020, rreth orës 10:00, në lokalin "01" që gjendet në rrugën "M. F." në Prishtinë, të pandehurit me dashje dhe në bashkëkryerje, kanë përdorur forcën ndaj M. S., tani i dëmtuari, në atë mënyrë që e kanë sulmuar duke e goditur me grushte dhe me shqelma në trup:-

- Me këtë kanë kryer veprën penale në bashkëkryerje *Sulm* nga neni 184 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Prandaj gjykata në bazë të nenit të poshtëshënuar dhe neneve 4; 81, 82 të KPRK, si dhe neneve 242, 365 të KPPK-së, të pandehurëve i shqipton:

VËREJTJE GJYQËSORE

Me të cilën i bëhet me dije se ka kryer një veprë të dëmshme shoqërore dhe të rrezikshme dhe se nëse kryen veprë tjetër penale do të dënohet më rëndë.

Obligohen të pandehurit që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguajë shumën aq sa do të bëhet sipas llogaritjes përfundimtare nga arka e gjykatës, në emër të paushallit gjyqësor në mënyrë solidare shumën prej tridhjetë (30) euro, në emër të kompensimit të viktimave në mënyrë solidare shumën prej njëzet (20) euro, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

I dëmtuari M. S. udhëzohet që për realizimin e kërkesës pasurore-juridike të drejtohet në kontest civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë/Departamenti i përgjithshëm, me aktakuzën me shenjë, PP.II.nr.3319/20, të datës 05.10.2020, i ka akuzuar M.G. dhe E.G. për shkak të veprës penale në bashkëkryerje *Sulm* nga neni 184 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar dhe ka mbajtur shqyrtimin fillestar, ku pas leximit të dispozitivit të aktakuzës nga prokurori i shtetit, gjykata i ka mundësuar të pandehurëve pranimin e fajësisë apo të deklarohen të pafajshëm.

Të pandehuri me vullnet të plotë dhe e vetëdijshme për pasojat e pranimin të fajësisë e ka pranuar në tërësi fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë sipas aktakuzës së prokurorit të shtetit, duke shtuar:

I pandehuri M.G. deklaron: E pranoj fajësinë, me te dëmtuarin mandej nuk kemi pas telashe, ai ka ardh ne lokalin tone, ka qene myshteri ne lokalin tone Fast Food Hamburger, me vjen keq, nuk kemi pase telashe me kerkon, edhe na vet kemi dashte me largu prej lokalit per shkak se bejke probleme ne lokalin tone dhe i ngucke femrat aty, gje qe na e prishke reputacionin e lokalit, dhe na i largojke myshterite, i premtoj gjykates qe asnjehere nuk do te perserise veper penale, nuk kemi asnje rast te hapur ne polici.

I pandehuri E.G. deklaron: E pranoj fajesine, me te demtuarin mandej nuk kemi pas telashe, ai ka ardh ne lokalin tone, ka qene myshteri ne lokalin tone Fast Food Hamburger, me vjen keq, nuk kemi pase telashe me kerkon, edhe na vet kemi dashte me largu prej lokalit per shkak se bejke probleme ne lokalin tone dhe i ngucke femrat aty, gje qe na e prishke reputacionin e lokalit, dhe na i largojke myshterite, i premtoj gjykates qe asnjehere nuk do te perserise veper penale, nuk kemi asnje rast te hapur ne polici.

Prokurori i shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurve ka deklaruar se nuk e kundërshtojnë pranimin e fajësisë, dhe si rrethanë lehtësuese të merret pranimi i fajësisë si deh fakti që nuk janë dënuar më parë.

Nga thëniet e vet të pandehurve në shqyrtimin fillestar u vërtetua se ai me datë kohë dhe vend si në dispozitivin e aktakuzës së ngritur ndaj tij ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet. Po ashtu nga provat materiale që gjenden në shkresat e lëndës, gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurës formësohen të gjitha elementet qenësore objektive dhe subjektive të veprës penale,

për të cilën akuzohet e pandehura. Andaj, gjykata të njëjtën e shpalli fajtor, pasi qe gjeti se penalisht është e përgjegjshme dhe e gjykoj si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit, gjykata kishte parasysh se dënimi penal përfaqëson reagimin shtetëror ndaj subjekteve të gjetura fajtor për kryerjen e një veprë penale, duke synuar jo vetëm ndëshkimin por njëkohësisht edhe edukimin dhe parandalimin e kryerjes së veprës penale në të ardhmen. Në këtë kuptim gjykata në pajtim me nenin 38 të KPRK-së mbi qëllimin e dënimit, në caktimin e të njëjtit është udhëhequr jo vetëm nga parimi i ligjshmërisë dhe domosdoshmërisë së dënimit, por njëkohësisht edhe nga parimi i dobishmërisë dhe individualizimit të tij, duke vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, të cilat komform nenit 69 të KPRK-së, ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit.

Me rastin e përcaktimit të dënimit, gjykata i vlerësoi të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, të cilat konform nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit e të cilat janë me ndikim me rastin e dënimit, ashtu që ndaj të pandehurve gjykata mori në konsideratë rrethanat lehtësuese se: është penduar për veprën penale, nuk ka qenë më herët kryerës të ndonjë veprë penale tjetër, ndërsa rrethanë rënduese gjykata nuk gjeti, dhe duke u nisur nga të gjitha këto gjykata i shqiptoi të pandehurëve vërejtjen gjyqësore si në dispozitivin e këtij aktgjykimi me bindje se ky dënim është adekuat me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe shkallën e përgjegjësisë penale të të pandehurit dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit, i paraparë me nenin 38 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor, u mor në bazë të nenit 450 KPPK.

Në bazë të nenit 463, par. 1 dhe 2, të KPPK-së, pala e dëmtuar është udhëzuar në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore-juridike.

Nga sa u tha më lart, dhe në bazë të nenit 364 të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti i përgjithshëm-Penal
P.nr.1881/20, të dt:10.01.2025

Bashkëpunëtori Profesional,
Lavdim Mehmeti

Gjyqtarja,
Edita Çanta

UDHËZIMI JURIDIK:

Kundër këtij aktgjykimi ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda tridhjetë (30) ditësh, nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimit. Ankesa bëhet përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.